

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mehmeti kundër Vuçiqit: Mohimi i katastrofës humanitare në Kosovë sfidon dëshmitë e luftës
ADRESA	https://albeu.com/kosove/mehmeti-kunder-vuciqit-mohimi-i-katastrofes-humanitare-ne-kosov-e-sfidon-deshmite-e-luftes/1028019/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:13:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:11:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	627c71ade6773a008aafa16ca6ee52feb1b16f4c9c566637791abd406ac951ce
TEKSTI	dca92000ece7d8c39c7e3c039c63816d274d384fda9a3e047290fe6b3293ecdc
PAMJA	323c44cc28c841496c20797a507b41c71690f654661cdb4a1d9db2faf7f290a9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b74d694b13e75f5c2a0379ac2ddae9578a1e9cd2f02f4dca13cbd11df6cb8ed5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	df7a3e632afe7e8acb9ac556f323199c5ae38613c8b46aabf6598ebdbd0b152a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b74d694b13e75f5c2a0379ac2ddae9578a1e9cd2f02f4dca13cbd11df6cb8ed5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mehmeti kundër Vuçiqit: Mohimi i katastrofës humanitare në Kosovë sfidon dëshmitë e luftës



Opinionisti Gani Mehmeti ka kundërshtuar deklaratën e presidentit serb Aleksandar Vuçiq, i cili ka mohuar se në Kosovë kishte ndodhur një katastrofë humanitare. Sipas Mehmetit, një qëndrim i tillë bie ndesh me realitetin e luftës dhe me krimet e kryera ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Ai thotë se nuk befasohet nga deklaratat e Vuçiqit, por nga fakti që ende mund të ketë persona që u japin besim atyre. Mehmeti vlerëson se presidenti serb po injoron dëshmitë e drejtpërdrejta të të mbijetuarve, si dhe raportet e dokumentet e organizatave ndërkombëtare.

"Për Vuçiqin nuk do të ishte katastrofë humanitare as sikur të vriteshin të gjithë shqiptarët e Republikës së Kosovës. Nuk më çudit ajo që thotë ai, por ata që ende mund t'i besojnë", ka deklaruar Mehmeti për "Bota sot".

Mehmeti kujton se gjatë viteve 1998 dhe 1999 institucionet dhe organizatat ndërkombëtare patën mundësi të evidentonin pasojat e luftës në Kosovë. Ai thekson se dëshmitë për dëbimet, vrasjet dhe shkatërrimet ishin të shumta.

Sipas tij, pas nisjes së bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, sulmet e forcave serbe dhe të formacioneve paraushtarake ndaj civilëve shqiptarë u shtuan ndjeshëm.

Ai ka shkruar se forcat serbe, në shenjë hakmarrjeje për bombardimet e qaveve ushtarake dhe policore, u sulën kundër popullsisë së pafajshme shqiptare. Sipas përshkrimit të tij, shqiptarët ndiqeshin shtëpi më shtëpi, ata që nuk largoheshin vriteshin, ndërsa banesat dhe objektet ekonomike digjeshin.

Opinionisti përmend gjithashtu masakrat e kryera ndaj civilëve gjatë dëbimit të tyre. Ai thotë se shqiptarët u përballën me dhunë edhe teksa përpiqeshin të largoheshin drejt maleve ose kufijve të Kosovës.

"Masakra të shumta u kryen edhe në kolona, gjatë ikjes së shqiptarëve drejt maleve dhe në çdo vend ku serbët e

të fundit /



Irani propozon armëpushim 7-ditor dhe rihapjen e Ngushticës...



Maran i surprizon të gjithë, dërgon në tribunë katër futbollist...



Sot dita e 119-të e protestës, qytetarët rikthehen në shesh...



Parashikimi i motit për 26 shtator 2026: Kthjellime dhe...



Zidane konfirmon shqetësimin për Mbappen: sulmuesi...



Horoskopi 26 Shtator/ Dashuri dhe debate, zbuloni surprizat e...



Salianji: PD-ja ka humbur sheshin e protestës, Berisha nu...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

panë të mundur. Këto krime, të numërta me qindra, nisën me familjen e komandantit legjendar Adem Jashari në vitin 1998 dhe vazhduan gjatë bombardimeve të NATO-s, nga 24 marsi deri më 20 qershor 1999", është shprehur Mehmeti.

Ai e lidh katastrofën humanitare edhe me përmasat e zhvendosjes së popullsisë shqiptare. Sipas tij, një pjesë e madhe e banorëve u detyrua të largohej nga Kosova drejt Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, ndërsa pjesa tjetër kërkoi strehim në male e bjeshkë.

"Si mund të thuhet se nuk kishte katastrofë humanitare, kur rreth gjysma e popullit shqiptar u dëbua në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi, ndërsa gjysma tjetër, bashkë me pleq, plaka, fëmijë dhe të sëmurë, u detyrua të strehohej në male e bjeshkë?", ka shkruar ai.

Mehmeti nënvizon se të zhvendosurit brenda Kosovës jetonin në kushte tejet të rënda. Mungesa e ushqimit, ilaçeve, mjekëve dhe strehimit, sipas tij, e përkeqësoi edhe më shumë gjendjen e civilëve.

Ai përmend edhe bilancin e viktimave shqiptare, duke theksuar se gjatë luftës u vranë rreth 13 mijë shqiptarë. Në mesin e tyre, sipas Mehmetit, kishte persona të moshave të ndryshme, nga të moshuar 90-vjeçarë deri te fëmijë të porsalindur.

"Rreth 13 mijë shqiptarë u vranë nga serbët, përfshirë pleq 90-vjeçarë dhe fëmijë të porsalindur, të cilët nuk mund të ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata u vranë vetëm pse ishin shqiptarë", ka deklaruar Mehmeti.

Në përmbyllje, opinionisti e ka ashpërsuar edhe më tej kritikën ndaj presidentit serb. Ai pretendon se mohimi i katastrofës humanitare lidhet drejtpërdrejt me urrejtjen e Vuçiqit ndaj shqiptarëve.

"E them qartë se, për Vuçiqin, nuk do të kishte katastrofë humanitare edhe nëse në Kosovë nuk do të mbetej asnjë shqiptar i gjallë. Kjo, sipas meje, është pasojë e urrejtjes së tij të madhe ndaj shqiptarëve", ka përfunduar Mehmeti.

Shtuar më 26.09.2026 08:11



Protesta "Jo në emrin tim" vijon edhe nën shi, Haziri u bën thirrje deputetëve të...



Kurti i kërkon Danimarkës përkrahje për avancimin e aplikimit të Kosovës drejt...



Prokuroria Speciale akuzon gjashtë persona për mashtrim dhe krime...



Ngërçi politik i kushton Kosovës mbi 40 milionë euro fonde të BE-së




Masakra e Mejës: Gjykata lejon gjykimin në mungesë të 53 të akuzuarve



Konjufca: Marrëdhëniet rajonale duhet të ndërtohen mbi barazi dhe respekt të...



Policia e Kosovës dhe FBI-ja zgjerojnë partneritetin për sigurinë dhe luftën...



Violeta Kukaj i bashkohet protestës në Prishtinë, ku jehon "Ai është i gjallë



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.